

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 150/1 prot.

Vlorë, më 01.02.2018

VENDIM

Nr. 3, datë 01.02.2018

**PËR
PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK
DHE PERSONELIT ADMINISTRATIV**


Në mbështetje të neneve **66, 67** të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, në funksion të hartimit të strukturës së përgjithshme të institucionit, si dhe numrit të personelit të UV-së në të gjitha nivelet, Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.02.2018

VENDOSI:

1. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni do të jenë:
 - a) Strukturat e kurrikulave;
 - b) Strukturat e kërkimit shkencor;
 - c) Strukturat e projekteve;
 - d) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;
 - e) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;
 - f) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë;
 - g) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
 - h) Strukturat e karrierës;
 - i) Strukturat e bibliotekave;
 - j) Strukturat juridike;
 - k) Strukturat e teknologjisë së informacionit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK**

- l) Strukturat e burimeve njerëzore;
 - m) Strukturat e arkiv-protokollit;
 - n) Asistent i rektorit.
2. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore janë:
 - a) Sekretaritë mësimore të njësive kryesore;
 - b) Asistent i dekanit.
3. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë janë:
 - a) Sekretaritë në departamente që përmbushin kriterin e pikës 10 të udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017.
4. Personeli i strukturave sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi konsiderohen personel ndihmësakademik me karakter administrativ në kuptim të pikës 3 të nenit 66 të ligjit 80/2015.
5. Strukturat ndihmësakademike me karakter mësimor në nivel njësie bazë;
 - a) Laborantët
 - b) Specialistët e QKSH-ve
6. Personeli i strukturave sipas pikës 6 të këtij vendimi konsiderohen personel ndihmësakademik me karakter mësimor në kuptim të pikës 2 të nenit 66 të ligjit 80/2015.
7. Strukturat administrative në nivel institucioni janë:
 - a) Bordi i administrimit;
 - b) Administratori i institucionit;
 - c) Strukturat e auditimit të brendshëm;
 - d) Strukturat ekonomike;
 - e) Strukturat e investimeve;
 - f) Strukturat e prokurimeve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

g) Strukturat e shërbimeve;

8. Personeli i strukturave sipas pikës 7 gërma **c, d, e, f** dhe **g** të këtij vendimi konsiderohen personel administrativ në kuptim të nenit **67** të ligjit 80/2015.
9. Vendimet e SA-së me nr. 39, datë 06.10.2016 dhe nr. 26, datë 10.02.2017, si dhe cdo akt tjetër i brendshëm i UV-së që bie ndesh me këtë vendim shfuqizohen.
10. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm të kategorizimit të personelit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Senatit Akademik

Prof. Dr. Roland Zisi



